



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



SHIBA zhvendos operacionet e ambasadës nga Kievi në Lviv



Vangjell zbulon për herë të parë: Francezët i morën makinën ish-kryeministrit shqiptar, ishte e një personazhi



Rëmbou biznesmenin Hait Nazifi, Kushetuesja i 'pret shpresat' për liri ish-anëtarit të "Hakmarjes për Drejtësi" Gentian Caka, historia e pengmarjes për 1 milionë USD



Një shtëpi plot me kanabis 1 km më tutje, shtëpia e fshatit: Një grua me makinë një dha numrin e telefonit dhe më tha 'Jejja futuristit'



E rëndë, ushtria ukrainase vret dy emigrantë grekë në kufirin 'e nxehtë' me Rusinë dhe plagos dy të tjerë


Kronikë

U prangos nga RENEA për vrasjen e dyfishtë në Lezhë, ekzaminim armës së gjetur në banesën e 39-vjeçarit Përdoda! Mund të jetë përdorur në ekzekutim

Arma e zjarrit kallashnikov e gjetur në banesën e 39-vjeçarit Edmond Përdoda i cili u arrestua të premtën nga forcat RENEA në Lezhë, si autor i dyshuar për një vrasje të dyfishtë do të ekzaminohet, për të parë nëse është përdorur në ngjarjen 27-prillit të vitit 2020 në fshatin Lalm Lukaj të Lezhës.



RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com



Redaksia

13 Shkurt, 11:24 | Përditësimi i fundit: 13 Shkurt, 14:59



Arma e zjarrit kallashnikov e gjetur në banesën e 39-vjeçarit Edmond Përdoda i cili **u arrestua të premtën** nga forcat RENEA në Lezhë, si autor i dyshuar për një vrasje të dyfishtë do të ekzaminohet, për të parë nëse është përdorur në ngjarjen 27-prillit të vitit 2020 në fshatin Lalm Lukaj të Lezhës. Referuar faktit se rapsodi Kol Murrani dhe miku i tij Preng Simoni u gjeten të ekzekutuar me breshëri automatiku, prokuroria nuk përjashton mundësinë se arma e gjetur mund të jetë përdorur në këtë krim të dyfishtë. Ashtu si vëllai i tij Aleksander Përdoda i arrestuar menjëherë pas ngjarjes, gjatë marrjes në pyetje edhe vetë Edmond Përdoda ka mohuar të ketë lidhje me vrasjen e dyfishtë në fshatin Lalm Lukaj. Sipas burimeve aktualisht arma e gjetur në banesë, municioni luftarak dhe një sasi baruti, të cilat janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale po ndiqen si procedim penal i ri, por nëse ekzaminimet do të vërtetojnë se arma mund të jetë përdorur në vrasje procedimi do bashkohet me atë të vrasjes së ndodhur në prill të vitit 2020. Pas gati dy vitesh në arrati, Edmond Përdoda u prangos pa bërë rezistence mëngjesin e së premtes nga forcat RENEA, pran banesës së tij në fshatin Lalm i Ri në periferi të qytetit të Lezhës, ndërsa rezultoi të jetë person me precedent penal i dënuar më parë në shtetin grek, për veprën penale "Vrasja", dhe në Shqipëri, për armëmbajtje pa leje dhe shkatërrim prone.

Ky shtetas ishte shpallur në kërkim, pasi Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka lëshuar urdhër ndalimi, për veprat penale "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese", kryer në bashkëpunim dhe "Armëmbajtja pa leje", sepse dyshohet që në bashkëpunim me vëllanë e tij, shtetasin Aleksander Përdoda (i arrestuar me parë), kanë vrarë me armë zjarri shtetasit Kol Murrani dhe Preng Simoni, ngjarje e ndodhur në muajin prill të vitit 2020 në fshatin Lalm Lukaj të Njesisë Administrative të Kolshit në Lezhë. Edmond Përdoda po mbahet në dhomat e paraburgumit të Komisarariatit të Policisë Lezhë në pritje për tu njohur me masën e sigurisë në gjykatë, seancë e cila pritet të zhvillohet ditën e hënë.



LEXO EDHE:

Me short publik, shpërndahen çelësat e apartamenteve të zonës 1/1 në Laç

Arrestimi të premtën

"Afrohu, afrohu, rrotullohu mbrapsht"...është kjo një sekuencë nga operacioni i forcave të RENEA-s në arrestimin e 39-vjeçarit, Edmond Përdoda, një person me rrezikshmëri të lartë, pasi ka ekzekutuar së bashku me vëllanë e tij, 2 persona. Arrestimi i tij është bërë teksa fshihej në një banesë 2 katëshe në fshatin "Lalm i Ri" të Lezhës, ku forcat RENEA dhe Policia e Lezhës me blind i kanë bërë 'pritë' në derën kryesore duke çuar në pranga autorin e vrasjes së dyfishtë, ngjarje e ndodhur në **27 prill të 2020**, ku viktimat mbetën Kol Murrani, rapsod i njohur në zonë dhe Preng Simoni. 39-vjeçari, i dënuar më parë në Greqi, prej gati 2 vitesh ishte në kërkim për vrasjen e rapsodit dhe mikut të tij, e ndërsa në banesë iu gjet një kallashnikov, municion luftarak dhe një sasi baruti.

Si ndodhi ngjarja?

Rapsodi Kol Murrani dhe miku i tij Preng Simoni u gjeten të vrarë me armë zjarri më 27 prill të vitit 2020, pranë **shtëpive të tyre** të vjetra në fshatin Lalm i Vjetër, të Njesisë Administrative të Kolshit. Ata kishin shkuar në vendlindje që prej orëve të mëngjesit të asaj dite, por u përballën me persona të armatosur që kishin mbjellë kanabis në tokat e tyre. Pa pasur dijeni për atë se çfarë ndodhte në tokat e tyre në zonën e thellë malore, Aleksandër Përdoda dhe Edmond Përdoda, i kanë qëlluar me armë sapo dy shokët kanë zbuluar veprimtarinë e tij kriminale. Trupat e viktimave janë lënë në pyll për rreth 5 orë dhe janë gjetur nga djali i Preng Simonit, që kishte dalë të kërkonte babanë me të cilin kishte humbur çdo kontakt prej orësh të tëra.

K.T./Shqiptarja.com

TAG:

LezheEdmond PërdodaAleksandër PërdodaPreng SimoniKol Murrani

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës:

Situata Rusi-Ukrainë, mendoni se jemi në prag të një lufte?

PO

JO

NUK E DI

Lajme të tjera

Kronikë



Vrau rapsodin dhe mikun e tij, lihet në burg Edmond Përdoda: Krimin e kreuva i vetëm, arsye familjare, vëllai s'ka lidhje! 39-vjeçari tregon vendin ku i fshehu armët

14 Shkurt, 09:52


Kronikë



Aksident në Lezhë, makina përmbysët në rrugë, plagoset rëndë shoferja

14 Shkurt, 08:36

Kronikë



Fshehu poshtë rrobave çantën me 3 kg ar dhe ora luksoze, arrestohet 'korrierja' shqiptare në aeroportin e Stambollit! VIDEO nga ndalimi, e lidhur me grupin kriminal në Laç

12 Shkurt, 10:53

Kronikë



'Afrohu, rrotullohu!' RENEA me blind te dera e shtëpisë, arrestohet i riu që vrau rapsodin dhe mikun e tij në 2020 për kanabisin! VIDEO kur i vënë prangat

11 Shkurt, 09:19

Sociale



Vijon masakra me helmimin e qenve endacak në Lezhë, kafshët e ngordhura hidhen në Drin! Bashkia: Vepër kriminale, s'kemi gisht ne

Elvis Hila

11 Shkurt, 08:59


Kronikë



Pas debateve me familjarët, 32-vjeçari në Lezhë vetëplagoset me plumb në kokë, ndërron jetë në spital! Viktima i arrestuar më parë për grabitje

10 Shkurt, 15:28


Kronikë



U përplas nga kamioni në rrugën Milot-Rrëshen, 50-vjeçarja nuk i mbijeton plagëve të marra, ndërron jetë në Spitalin e Traumës

8 Shkurt, 20:36


Sociale



Masakra me helmimin e qenve në Lezhë, Bashkia asnjë strategji për trajtimin e tyre! Në buxhetin e 2022 një fond i posaçëm për rehabilitimin e qenve endacakë

8 Shkurt, 17:37

Kronikë



Përdhunoi të miturën në Kurbën dhe e kërcënonte vazhdimisht, Gjykata e Apelit në Tiranë dënon me 6 vite burg të riuin

8 Shkurt, 16:02

Kronikë



Gërryenin me ekskavator për të marrë inerte nga shtrati i lumit Mat, arrestohen tre persona në Milot

8 Shkurt, 12:18

Kronikë



Bien gurë të mëdhenj në buçin Skuraj-Burrel, shoferët ndalojnë dhe i largojnë vetë! Firma kontraktore nuk ndërhyr

7 Shkurt, 17:52

Sociale



Pas Korçës, qentë endacakë helmohen edhe në Lezhë, pamje të rënda të kafshëve të ngordhura në rrugë (VIDEO)

7 Shkurt, 17:04